



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 12.08.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.2) të Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022 ,e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 08.08.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “IZO - H “ SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Molerimi dhe suvatimi në shkollë “, Nr. i prokurimit- 632-25-2734-2-2-1, Nr. i brendshëm 632-25-036-221, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik “IZO - H “ SH.P.K., e dt.08.08.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Molerimi dhe suvatimi në shkollë “, Nr. i prokurimit- 632-25-2734-2-2-1, Nr. i brendshëm 632-25-036-221, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë 04.08.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë:04.08.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit .
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Arsyetim

Operatori Ekonomik "IZO - H " SH.P.K., me dt.08.08.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Molerimi dhe suvatimi në shkolla ", Nr. i prokurimit- 632-25-2734-2-2-1, Nr. i brendshëm 632-25-036-221.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 12.08.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet tuaja, janë të pa bazuara. Autoriteti kontraktues konsideron se ju nuk keni plotësuar kërkesat në FDT-së.

Ju keni prezantuar diplomën e inxhinjerit të ndërtimtarisë, po në diplomën e të njëjtit shkruan Inxhinjer i ndërtimtarisë e jo Inxhinjer i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv siç është kërkuar në FDT-ë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankësë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi të këtij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

